



Prishtinë, 24 qershor 2008  
Kodi i ZRRE-së: D\_089\_2008

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, duke u bazuar në:

1. Dispozitat e Nenit 15.2 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë të amendamentuar me Ligjin Nr.03/L-080”;
2. Dispozitat e Nenit 22 të Licencë së Operatorit të Sistemit të Transmisionit;
3. Kërkesën me shkrim të Operatorit të Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) SH.A. të dërguar në ZRRE me datë 08 shkurt 2008, në seancën e mbajtur me datë 24 qershor 2008, nxori këtë:

## VENDIM

### I. **APROVOHET** kërkesa e KOSTT SH.A për emërimin e ekspertit të pavarur.

1. Sipas Nenit 22 të licencës së Operatorit të Sistemit të Transmisionit, KOSTT ka për obligim të caktojë një ekspert të pavarur, emërimin e të cilit do ta aprovojë ZRRE-ja.
2. Me 08 shkurt 2008 KOSTT SH.A ka kërkuar nga ZRRE të aprovojë kërkesën për emërimin e **Z. Ali Gashi si ekspert i pavarur**, i cili do të kryejë kontrollin teknik dhe të sigurisë të Sistemit të Transmisionit në baza vjetore.
3. ZRRE ka shqyrtuar kërkesën e KOSTT-it dhe pas vlerësimit të biografisë së kandidatit ka aprovuar kërkesën që **Z. Ali Gashi** të jetë ekspert i pavarur i cili në bazë vjetore do të kryejë kontrollin teknik dhe të sigurisë të Sistemit të Transmisionit.
4. Ky Vendim nxirret në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht. Në rast të mospërputhjes midis gjuhëve, do të mbisundojë versionin në gjuhën shqipe.
5. Pala e pakënaqur, mund të paraqesë ankesë kundër këtij Vendimi në gjykatën e juridiksionit përkatës, brenda 14 ditësh nga data e miratimit ose datës së publikimit të vendimit në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.
6. Ky Vendim hyn në fuqi me datën e lëshimit të tij ose në datën e publikimit të tij në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së



ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI  
ENERGY REGULATORY OFFICE  
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU

Bashkëngjitur: Biografia e Z. Ali Gashi

Bordi i ZRRE-së:

---

Ali Hamiti, Kryesues

---

Theranda Beqiri, Anëtare

---

Nysret Avdiu, Anëtar